

Përmbledhje

GJYQTARJA E GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR FIER, ZNJ. OLKEDA LICE PËRBALLET ME PROCESIN E RIVLERËSIMIT PRANË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

**RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE
DATË 16/12/2022 PRANË KPK:**

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tre kriteret e rivlerësimit, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

Nga institucionet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI dhe DSIK, ishin paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit.

Raporti i KLGJ ishte pjesërisht pozitiv dhe u kërkuan spjegime në lidhje me dosjet e shqyruara



**Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, znj. Olkeda Lice jep shpjegime përpara
trupës gjykuese të KPK mbi rezultatet e hetimit administrativ për tre kriteret e
rivlerësimit**

Më datë 16.12.2022 ora 10:00, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit znj. Olkeda Lice, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Trupa gjykuese përbëhej nga znj. Etleda çiftja (kryesuese), znj. Suela Zhegu (anëtare), znj. Alma Faskaj (relatore), si dhe u asistua nga vëzhguesi ndërkombëtar z. Teo Jacobs, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tre kriteret e rivlerësimit, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016. Gjatë seancës dëgjimore u vërejt se subjekti kishte zgjedhur të mbrohej vetë, pa përfaqësimin e një avokati dhe po ashtu nuk pati kërkesa paraprake apo procedurale në lidhje me hetimin administrativ ose konflikte të mundshme interesi me trupën gjykuese.

Nga institucionet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI dhe DSIK, ishin paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit. Ndryshe nga këto raporte, Komisioni në hetimin administrativ, sa i takon kriterit të pasurisë ka konstatuar pamundësi financiare për personin e lidhur me subjektin e rivlerësimit për krijimin e një depozite bankare në bashkëpronësi, pasi të ardhurat e personit të lidhur nga bastet sportive nuk përmbushnin kriterin e ligjshmërisë dhe të mjaftueshmërisë. Në prapësim të gjetjeve të Komisionit, subjekti kërkoi që ish-bashkëshorti i saj të mospërfshihej si person i lidhur dhe se pasaktësitë në deklaratën vetting të konsiderohen si përgjegjësi personale e tij. Pasi i kaloi barra e provës, subjekti duhet të depozitojë referencën ligjore në mbështetje të pretendimeve të saj.

Lidhur me kriterin profesional, raporti i KLGJ ishte pjesërisht pozitiv, pasi nga shqyrtimi i 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të zgjedhura me short ishte arritur në konkluzione se subjekti kishte patur organizim të dobët të punës, kishte gjykuar çështje në tejkalim të afateve ligjore e disa parregullsi procedurale janë konstatuar. Lidhur me konstatimet, subjekti kundërshtoi gjetjet, duke argumentuar ndër të tjera se 2 çështjet e pretenduara si të gjykuara në kushtet e konfliktit të interesit nuk mund të konsiderohen të tilla, pasi marrëdhënia kontraktuale e qiradhënies ndërmjet saj dhe njëres prej palëve ndërgjyqëse ka përfunduar më herët. Pranë Komisionit 4 qytetarë kishin paraqitur denoncimet e tyre që konsistojnë në mosrespektimin e kërkesave procedurale të procesit gjyqësor. Subjekti iu përgjigj proaktivisht pyetjeve të adresuara nga ana e trupës gjykuese, si dhe vëzhguesit ndërkombëtar.

Në përfundim të seancës, Komisioni caktoi **datën 19.12.2022 ora 09:50**, për shpalljen e vendimit përfundimtar.